



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2761 Prot.

Roskovec, më 08.04 2021

V E N D I M

Nr. 23, datë 08/04 /2021

"PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PËR MBROJTJEN CIVILE PËR NDËRTIMIN

EMERGJENT TË OBJEKTIT : "PËRFORCIM I URËS AUTO MBI KOLEKTOR , FSHATI SUK 2"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23 , neni 29 si dhe neni 54 , gërma dh , të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" të ligjit 68/2017 "Për financat e veteqeverisjen vendore" neni 45 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar neni 44 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", vendimit të Këshillit të Bashkisë , të VKB nr.89 datë 02.12.2020 "Për miratimin e buxhetit , numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse si dhe nivelin maksimal të pagave për vitin 2021" si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe sektori i shërbimeve;Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e fondit prej **1,229,208 lekë** për ndërtimin emergjent për objektin : "Përforcim i urës Auto mbi kolektor , fshati Suk 2".
2. Financimi do të përballohet nga fondi i mbrojtjes civile nga Transferta e pakushtëzuar sektoriale 2021.
3. Ngarkohet Nëpunesi Autorizues , sektori i shërbimeve dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55 pika 6.

KRYETAR  
Kadri Hyska

